



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për Miratimin e Përfundimit të Përfaqësimit të Hashim Thaçit nga
Mbrojtësi**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(4)(e), 40(2) dhe (6)(h), 41(4)(b) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 25 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), dhe pjesëve 16(1), (2)(b) dhe (4) të Direktivës për Mbrojtësit ("Direktiva"),¹ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 janar 2024, Administratorja kërkoi miratimin e përfundimit të përfaqësimit të Hashim Thaçit ("z. Thaçi") nga mbrojtësi Gregori Kihou ("z. Kihou"), ("Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit").²
2. Më 19 janar 2024, z. Kihou dorëzoi mocionin për t'u tërhequr si mbrojtës, së bashku me nëntë anëtarë të tjerë të ekipit të Mbrojtjes së Thaçit ("Mocioni").³
3. Më 26 janar 2024, Administratorja dorëzoi parashtrime shtesë në lidhje me Mocionin ("Parashtrimet Shtesë").⁴
4. Më 29 janar 2024, Administratorja njoftoi Trupin Gjykues lidhur me letrën nga z. Kihou ("letra e Kihout") që përmbante informacion shtesë në lidhje me Mocionin ("informacioni shtesë").⁵
5. Më 31 janar 2024, Administratorja njoftoi Trupin Gjykues, z. Thaçi dhe ekipin e tij Mbrojtjes, lidhur me përgjigjen që mori me email nga Ministria e Drejtësisë së

¹ KSC-BD-04-Rev1, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, *Direktivë për Mbrojtësit*, 28 prill 2021.

² F02068, Administratorja, *Njoftim i Hashim Thaçit drejtuar Trupit Gjykues dhe Kërkesë për Miratim të Përfundimit të Përfaqësimit nga Mbrojtësi*, 19 janar 2024, konfidencial, me Shtojcë, konfidenciale.

³ F02069, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion për Tërheqje nga Kryembrojtësi i Hashim Thaçit*, 19 janar 2024, para. 10, 21.

⁴ F02079, Administratorja, *Parashtrime Shtesë të Administratores në lidhje me Përfundimin e Përfaqësimit nga Mbrojtësi dhe Anëtarë të Tjerë të Ekipit Mbrojtës*, 26 janar 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ F02088, Administratorja, *Njoftim për Letrën me Informacion Shtesë nga Mbrojtësi që Kërkon Përfundimin Para Kohe*, 29 janar 2024, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojë, konfidenciale dhe *ex parte*.

Kosovës në lidhje me financimin e përfaqësimit të z. Thaçi (“Njoftimi i Administratores”).⁶

6. Më 31 janar 2024, Trupi Gjykses mbajti një seancë *ex parte* me z. Thaçi dhe mbrojtësit, z. Kihou dhe z. Luka Mishetiq (“z. Mishetiq”) për të diskutuar përfaqësimin e z. Thaçi.⁷

7. Më 31 janar 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj ndaj Mocionit (“Përgjigjja e ZPS-së”).⁸

8. Më 9 shkurt 2024, z. Mishetiq njoftoi Trupin Gjykses se ishte arritur marrëveshja që z. Mishetiq të zëvendësonte z. Kihou si mbrojtës (“Njoftimi për Marrëveshjen”).⁹

II. PARASHTRIME

9. Në Kërkesën për Përfundimin e Përfaqësimit, Administratorja kërkoi nga Trupi Gjykses të miratonte përfundimin e caktimit të z. Kihou si mbrojtës i z. Thaçi.¹⁰ Administratorja njoftoi Trupin Gjykses se kishte marrë një letër në të cilën z. Thaçi informonte se z. Kihou nuk do ta përfaqësonte më dhe se ai më tutje do të përfaqësohej nga anëtarët e tjerë të ekipit të tij ligjor (“letra e Thaçit”).¹¹ Administratorja tha gjithashtu se z. Thaçi bëri të ditur gojarisht se z. Mishetiq do të zëvendësonte z. Kihou si mbrojtës të tij.¹²

⁶ F02093, Njoftim për Letrën me Informacion Shtesë në lidhje me Kërkesën për Përfundimin Para Kohe të Përfaqësimit, 31 janar 2023, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcë, konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ Transkripti i seancës konfidenciale dhe *ex parte*, 31 janar 2024, f. 12350-12364.

⁸ F02094, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë në lidhje me Mocionin për Tërheqje të Kryembrojtësit të Hashim Thaçit, 31 janar 2024, konfidenciale.

⁹ F02116, Mbrojtësi i Specializuar, Njoftim drejtuar Trupit Gjykses në lidhje me Angazhimin e Mbrojtësit të Ri, 9 shkurt 2024, konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁰ Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit, para. 3.

¹¹ Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit, para. 1.

¹² Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit, para. 2, poshtëshënimi 3. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1. *Shih gjithashtu* Informacionin Shtesë, para. 7.

10. Në Mocion, z. Kihou kërkoi nga Trupi Gjykses që t'i lejonte tërheqjen si kryembrojtës, së bashku me një bashkëmbrojtës, tre ndihmës juridikë dhe pesë ndihmës administrativë të ekipit të Mbrojtjes së Thaçit ("anëtarë të tjerë të ekipit të Mbrojtjes") ("Kërkesa për Tërheqje").¹³ Z. Kihou parashtrroi se z. Thaçi: (i) nuk kishte përmbushur detyrimin ndaj tij dhe anëtarëve të tjerë të ekipit të mbrojtjes; dhe (ii) ishte paralajmëruar si duhet se z. Kihou dhe anëtarët e tjerë të ekipit të mbrojtjes do të kërkonin përfundimin nëse nuk përmbushesh detyrimi.¹⁴ Krahas kësaj, z. Kihou kërkoi që Administratorja të udhëzohej të caktojë një mbrojtës të specializuar për z. Thaçi sipas pjesës 12(1)(b) të Direktivës, pa pagesë nga z. Thaçi nëse ai nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për pagesë ("Kërkesa për Caktimin").¹⁵ Së treti, duke theksuar se ai dhe anëtarët e tjerë të ekipit të Mbrojtjes do të vazhdojnë të veprojnë ose të ndihmojnë mbrojtësin zëvendësues për një periudhë jo më shumë se dyzet e pesë ditë nga data e caktimit ose emërimit të mbrojtësit zëvendësues, z. Kihou kërkoi që Trupi Gjykses të udhëzojë Dhomat e Specializuara ("DHS") të paguajnë për shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme që do të kenë ai dhe anëtarët e ekipit gjatë periudhës tranzitore ("Kërkesa për Pagesë").¹⁶

11. Sa i përket Kërkesës për Tërheqje, Administratorja informoi Trupin Gjykses, ndër të tjera, se: (i) ajo nuk kishte marrë informacion nga z. Kihou në lidhje me arsye të bindëse;¹⁷ dhe (ii) nëse tërhiqen z. Kihou dhe anëtarët e tjerë të ekipit të mbrojtjes, ekipi i Mbrojtjes së Thaçit do të vazhdojë të përbëhet nga 26 persona, përfshirë gjashtë bashkëmbrojtës me përvojë.¹⁸ Sa i përket Kërkesës për Caktimin, Administratorja theksoi se z. Thaçi nuk ka kërkuar as emërimin, as caktimin e mbrojtësit zëvendësues; e as nuk ka parashtruar informacionin e nevojshëm për të

¹³ Mocioni, para. 10, 21(i).

¹⁴ Mocioni, para 9-11, 21.

¹⁵ Mocioni, para 14, 21(ii).

¹⁶ Mocioni, para 18-19, 21(iii).

¹⁷ Parashtrimet Shtesë, para. 3.

¹⁸ Parashtrimet Shtesë, para. 4-5.

vlerësuar nëse atij i mungojnë mjetet financiare për të marrë në shërbim mbrojtës sipas Rregullores për Ndihmë Juridike.¹⁹ Sa i përket Kërkesës për Pagesë, Administratorja parashtrori se mjete që kërkohet është i parakohshëm, sepse ajo ende nuk është në pozitë të vlerësojë nëse përlijet periudha kalimtare e punës sipas pjesës 16(4) të Direktivës.²⁰

12. Bazuar në letrën e Kihout,²¹ Administratorja parashtrori se ajo bindet se janë treguar arsye të bindëse për përfundimin para kohe dhe rrjedhimisht përsëriti kërkesën e saj që Trupi Gjykses të miratojë përfundimin para kohe të përfaqësimit prej z. Kihou.²² Së fundi, duke theksuar se ajo ende nuk ka marrë përgjigje në lidhje me këtë aspekt, Administratorja kërkoi që Trupi Gjykses të kërkojë konfirmim nga z. Thaçi dhe z. Mishetiq në lidhje me përfaqësim të z. Thaçi nga mbrojtësi tash e tutje.²³

13. ZPS-ja përgjigjet se Mocioni ishte i parakohshëm dhe duhet të hidhet poshtë.²⁴ ZPS-ja parashtron se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të tërheqjes së z. Kihou në vijimësinë e përfaqësimit dhe kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor, në veçanti duke pasur parasysh se z. Thaçi ende nuk ka kërkuar emërimin ose caktimin e kryembrojtësit të ri.²⁵

14. Gjatë seancës *ex parte* të datës 31 janar 2024, Trupi Gjykses mori konfirmim nga: (i) z. Thaçi dhe z. Kihou se ata ishin të mendimit se lidhja e tyre profesionale kishte përfunduar pa gjasa përmirësimi; dhe (ii) z. Thaçi dhe z. Mishetiq bënë të ditur se ata po diskutonin zëvendësimin e z. Kihou si kryembrojtës dhe se do ta informonin Trupin Gjykses deri të premtën, 9 shkurt 2024.²⁶

¹⁹ Parashtrimet Shtesë, para. 7-8.

²⁰ Parashtrimet Shtesë, para. 9-10 që i referohen pjesës 16(4) të Direktivës.

²¹ Informacioni Shtesë; Letra e Kihou.

²² Informacioni Shtesë, para. 6; Letra e Kihou.

²³ Informacioni Shtesë, para. 7.

²⁴ Përgjigja e ZPS-së, para. 1.

²⁵ Përgjigja e ZPS-së, para. 3.

²⁶ Transkripti i seancës konfidenciale dhe *ex parte*, 31 janar 2024, f. 12351-12355, 12358-12359, 12364-12365.

15. Së fundi, nëpërmjet Njoftimit për Marrëveshjen, z. Mishetiç bëri me dije se: (i) në bazë të marrëveshjes së tij me z. Thaçi, ai kishte kërkuar që Zyra Administrative të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të mundësuar emërimin e tij si mbrojtës; (ii) synon të përfundojë procesin e angazhimit të bashkëmbrojtësit deri në fund të shkurtit 2024; dhe (iii) z. Pitër Mekloski do të ndihmonte si “bashkëmbrojtës”, sipas nevojës.²⁷

III. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

16. Sipas neneve 21(4)(e) dhe 41(4)(b) të Ligjit, një i akuzuar ka të drejtën “të mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë; dhe t’i caktohet Mbrojtës i Specializuar, në çdo rast kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë, dhe pa pagesë në rast se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar”.

17. Sipas pjesës 16(1) të Direktivës, gjatë shqyrtimit të përfundimit para kohe të përfaqësimit të një të akuzuari nga mbrojtësi i specializuar, Administratori i kushton rëndësinë e duhur vazhdimin të përfaqësimit dhe duhet të marrë miratimin e panelit të ngarkuar me çështjen në të cilën vepron mbrojtësi.

18. Sipas pjesës 16(2)(b) të Direktivës, Administratori “e përfundon përfaqësimin nga mbrojtësi në rrethanat e mëposhtme: [...] b. Mbrojtësi [...] [ose] i akuzuari [...] bëjnë kërkesë për tërheqje, duke dhënë arsye bindëse ndër të cilat rastet kur është prishur marrëdhënia konfidenciale midis mbrojtësit dhe klientit të vet”.

19. Sipas pjesës 16(4) të Direktivës:

Në interes të drejtësisë, Administratori mund të udhëzojë që mbrojtësi i emëruar ose i caktuar përfaqësimi i të cilit do të përfundohet, të vazhdojë të veprojë ose të ndihmojë mbrojtësin zëvendësues për një periudhë jo më shumë se dyzet e pesë (45) ditë nga data e caktimit ose emërimit të mbrojtësit zëvendësues. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të mbrojtësit që po largohet, përballohen nga Dhomat e Specializuara [DHS].

²⁷ Njoftimi për Marrëveshje, para. 1-2.

20. Aspektet që lidhen me caktimin dhe tërheqjen e mbrojtësit rregullohen kryesisht nga Direktiva, dhe në masë më të vogël nga Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Kodi”).²⁸ Të dyja instrumentet janë miratuar në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.²⁹ Rregullorja dhe të gjitha instrumentet përkatëse, përfshirë Direktivën dhe Kodin, duhen lexuar dhe zbatuar në varësi të Ligjit, i cili krijoi DHS-në dhe ZPS-në.³⁰ Ky është raport i natyrshëm midis një instrumenti mundësues dhe instrumenteve të tjera, përfshirë Rregulloren dhe Direktivën, nga i cili burojnë.³¹

IV. DISKUTIM

A. JURIDIKSIONI I TRUPIT GJYKUES MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJE

21. Në lidhje me tërheqjen e z. Kihou, Trupi Gjykses ka marrë në shqyrtim dy kërkesa paralelisht: (i) Kërkesën për Përfundim të Përfaqësimit, të dorëzuar nga Administratorja, që kërkon miratimin prej Trupit Gjykses të përfundimit të përfaqësimit të z. Thaçi nga z. Kihou; dhe (ii) Kërkesën për Tërheqje të z. Kihou, përmes së cilës ai kërkon që Trupi Gjykses t’i lejojë tërheqjen si kryembrojtës, së bashku me një bashkembrojtës, tre ndihmës juridikë dhe pesë ndihmës administrativë të ekipit të Mbrojtjes së Thaçit. Megjithëse, nuk ka dyshim se pjesa 16(1) e Direktivës i kërkon Administratores të kërkojë miratim prej Trupit Gjykses kur shqyrton një kërkesë për përfundim ose pezullim para kohe të përfaqësimit, nuk ka dispozita që trajtojnë një situatë e cila tani i paraqitet Trupit Gjykses, kur

²⁸ KSC-BD-07-Rev1, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative: *Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, shih në veçanti nenin 25.

²⁹ Pjesa 1(1) e Direktivës; neni 1(1) i Kodit.

³⁰ *Shih* nenin 3 të Ligjit; rregullën 3(1).

³¹ ICTY, *Prosecutor v. Milošević*, IT-02-54-T, [Decision on Assigned Counsel’s Motion for Withdrawal](#) (“*Milošević Decision*”), 7 December 2004, para. 13.

Administratorja shqyrton gjithashtu një kërkesë të drejtpërdrejtë nga mbrojtësi ose i akuzuari, për tërheqje të mbrojtësit.

22. Rregulla 25(1) përcakton se përmbushja e kriterëve, përgatitja profesionale dhe përvoja, si edhe modalitetet e vetëtërheqjes dhe përjashtimit të mbrojtësve rregullohen në Direktivën për Mbrojtësit. Nga ana e vet, Direktiva përcakton se Administratorja vendos zakonisht për përfundimin e përfaqësimit.³² Kjo shtron pyetjen e juridiksionit të Trupit Gjykses për të vendosur në lidhje me aspekte që i janë paraqitur në Kërkesën për Tërheqje.

23. Në përputhje me qasjen e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") në lidhje me këtë aspekt, Trupi Gjykses bindet se "normalisht nuk është e përshtatshme që një Dhomë të shqyrtojë mocione për aspekte që janë kryesisht kompetencë e Administratorit".³³ Në anën tjetër, Trupi Gjykses pajtohet dhe me propozimin se do të ishte kompetent të marrë vendim lidhur me një aspekt që zakonisht është kompetencë e Administratores, nëse ajo ngre dhe kur ajo ngre aspekte që lidhen me drejtësinë e procesit.³⁴

24. Trupi Gjykses bindet se Kërkesa për Tërheqje e z. Kihou ka të bëjë me aspekte që lidhen me drejtësinë e procesit, të paktën kur lidhen me tërheqjen e z. Kihou, dhe për këtë arsye Trupi Gjykses ka konstatuar se ka juridiksion për të marrë vendim lidhur me këtë aspekt. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se Administratorja dhe Mbrojtja bënë të qartë se ata nuk vënë në dyshim kompetencën e Trupit Gjykses për të marrë vendim në lidhje me Kërkesën.³⁵

³² Pjesa 16 e Direktivës.

³³ ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Order on Esad Landzo's Motion for Expedited Consideration](#), 15 September 1999. *Shih gjithashtu Milošević Decision*, para. 10.

³⁴ *Shih p.sh.* ICTY, *Milošević Decision*, paras 11-12; IT-02-60-AR73.4, Appeals Chamber, *Prosecutor v. Blagojević*, [Public and Redacted Reason for Decision on Appeal by Vidoje Blagojevic to Replace his Defence Team](#), 7 November 2003, paras 6-7.

³⁵ *Shih Kërkesën për Përfundimin e Përfaqësimit*, para. 3; *Kërkesën për Tërheqje*, para. 21(i).

B. KËRKESA PËR PËRFUNDIMIN E PËRFAQËSIMIT DHE KËRKESA PËR TËRHEQJE

25. Gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Përfundimin e Përfaqësimit dhe Kërkesës për Tërheqje, Trupi Gjykses mban parasysh të drejtën e z. Thaçi sipas nenit 21(4)(e) të Ligjit për të zgjedhur mbrojtësin e vet. Sa u përket arsyeve bindëse, Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) z. Thaçi dhe z. Kihou konfirmuan vendimin e tyre për të përfunduar lidhjen e tyre avokat-klient;³⁶ (ii) z. Kihou konfirmoi se kontrata midis z. Thaçi, tij dhe anëtarëve të tjerë të ekipit mbrojtës përfundoi më 31 janar 2023 dhe se asnjëra palë nuk dëshironte të vazhdonte lidhjen profesionale;³⁷ dhe (iii) z. Kihou paraqiti arsye lidhur me honorarë të papaguar si bazë për Kërkesën për Tërheqje.³⁸ Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses bindet se janë dhënë arsye bindëse, brenda kuptimit të pjesës 16(2)(b) të Direktivës, për përfundimin para kohe të përfaqësimit të z. Thaçi nga z. Kihou.³⁹

26. Sa i përket vazhdimin të përfaqësimit, Trupi Gjykses vëren se z. Mishetiç konfirmoi se në varësi të vendimit të Administratores, ai do të zëvendësojë z. Kihou si kryembrojtës kur të përfundohen procedurat përkatëse sipas Direktivës.⁴⁰ Krahas kësaj, Trupi Gjykses thekson se as z. Thaçi,⁴¹ as Administratorja,⁴² as z. Kihou,⁴³ nuk kanë ngritur shqetësime në lidhje me vazhdimin e përfaqësimit të z. Thaçi. Përkundrazi, Trupi Gjykses thekson se: (i) z. Thaçi u shpreh se pjesa tjetër e ekipit të tij ligjor do të vazhdojë ta përfaqësojë dhe është e përkushtuar që ta përfaqësojë atë në mënyrën më të mirë të mundshme;⁴⁴ (ii) z. Kihou sugjeroi se

³⁶ Transkripti i seancës konfidenciale dhe *ex parte*, 31 janar 2024, f. 12354, rreshtat 12-24. *Shih gjithashtu* Mocionin, para. 10, 21; Letra e Thaçi; Letra e Kihout.

³⁷ Informacioni Shtesë, para. 4; Letra e Kihout.

³⁸ Letra e Kihout. *Shih gjithashtu* Informacionin Shtesë, para. 4.

³⁹ Informacioni Shtesë, para. 6.

⁴⁰ Njoftimi për Marrëveshje.

⁴¹ *Shih* Letrën e Thaçi. *Shih gjithashtu* Kërkesën për Përfundim e Përfaqësimit, para. 2.

⁴² Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit, para. 2.

⁴³ *Shih* Letrën e Kihout.

⁴⁴ Letra e Thaçi.

duke marrë parasysh numrin e anëtarëve të mbetur të ekipit të z. Thaçi dhe kompetencën e tyre, nuk nevojitet periudha tranzitore e punës nga mbrojtësi që po largohet;⁴⁵ dhe (iii) Administratorja parashtroi se nëse ndodh tërheqja e z. Kihou dhe e anëtarëve të tjerë të ekipit të Mbrojtjes, ekipi i Mbrojtjes së z. Thaçi ende përbëhet prej 26 persona, përfshirë gjashtë bashkëmbrojtës dhe pesë këshilltarë, me përvojë disavjeçare në këtë çështje gjyqësore.⁴⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykes, bindet se do të sigurohet vazhdimi i përfaqësimit të z. Thaçi.

27. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes gjykon se kërkesa për përfundimin para kohe të përfaqësimit të z. Kihou si mbrojtës i z. Thaçi përputhet me të drejtat e z. Thaçi dhe siguron përshtatshëm përfaqësim të efektshëm. Trupi Gjykes bindet se zëvendësimi nuk do t'i shkaktojë padrejtësi z. Thaçi ose të bashkakuzuarve të tij. Trupi Gjykes bindet gjithashtu se ndërrimi i kryembrojtësit nuk do të shkaktojë vonesa në procesin gjyqësor. Për këto arsye, Trupi Gjykes miraton Kërkesën për Përfundimin e Përfaqësimit dhe Kërkesën për Tërheqje, duke qenë se ajo lidhet me tërheqjen e z. Kihou.

28. Trupi Gjykes thekson se në Kërkesën për Tërheqje kërkohet gjithashtu një urdhër nga Trupi Gjykes i cili lejon tërheqjen e një bashkëmbrojtësi, z. Ridër, tre ndihmësve juridikë dhe pesë ndihmësve administrativë të ekipit të Mbrojtjes së Thaçit.⁴⁷ Pjesa 18(5) e Direktivës përcakton se nëse përfaqësimi ka përfunduar ose është pezulluar sipas pjesës 16 të kësaj Direktive, për arsye të vazhdimësisë dhe në këshillim me personin që përfaqësohet, përgjithësisht mbrojtësi zëvendësues përpiqet të vazhdojë përfaqësimin me anëtarët e ekipit të mbrojtësit të mëparshëm. Kjo dispozitë shton se bashkëmbrojtësi mund të emërohet ose caktohet si mbrojtës zëvendësues, me përjashtim të rasteve kur nuk i përmbush kriteret përkatëse të Pjesës 5, ose në qoftë se personi që përfaqësohet e kundërshton një zëvendësim të

⁴⁵ Letra e Kihout.

⁴⁶ Parashtrimet Shtesë, para. 5. *Shih gjithashtu* Informacionin Shtesë, para. 6.

⁴⁷ Kërkesa për Tërheqje, para. 1, 21(i).

tillë, ose nëse ekzistojnë arsye të tjera serioze kundër zëvendësimit. Në pjesën 18(6) në vijim thuhet se nëse mendon ta përfundojë kontratën me bashkëmbrojtësin, mbrojtësi informon për këtë Administratorin dhe duhet të demonstrojë se përfundimi i kontratës mund të kryhet pa shkaktuar pasoja ligjore negative ndaj interesave të klientit ose të klientëve dhe ndaj kohëzgjatjes së procedurës. Administratori informon panelin përkatës për sa më lart. Trupi Gjykses bindet se kërkesa për tërheqje të bashkëmbrojtësit në këtë rast mund të lidhet me aspektin e drejtësisë së procesit, aspekt ky i Kërkesës për Tërheqje, që Trupi Gjykses ka kompetencë për ta trajtuar. Trupi Gjykses konstaton gjithashtu se arsyet të cilat çuan Trupin Gjykses në përfundimin se ekzistenca e arsyeve bindëse për tërheqjen e z. Kihou vlen edhe për kërkesën lidhur me bashkëmbrojtësin. Për këtë arsye, Trupi Gjykses autorizon tërheqjen e z. Ridër si bashkëmbrojtës i z. Thaçi. Trupi Gjykses nuk gjykon se tërheqja e anëtarëve të tjerë të ekipit (tre ndihmës juridikë dhe pesë ndihmës administrativë) është aspekt që lidhet me drejtësinë e procesit që do të përlligjite ushtrimin e diskrecionit të tij lidhur me këtë pjesë të Kërkesës për Tërheqje. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon Administratoren që të trajtojë këtë aspekt të Kërkesës për Tërheqje.

C. KËRKESA PËR CAKTIM

29. Duke iu kthyer Kërkesës për Caktim, Trupi Gjykses vëren se që kur z. Kihou dorëzoi Mocionin, z. Mishetiq: (i) konfirmoi se ai dhe z. Thaçi kanë arritur marrëveshje që z. Mishetiq do të zëvendësojë z. Kihou si kryembrojtës;⁴⁸ dhe (ii) bëri të ditur se ai ka kërkuar nga Zyra Administrative që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mundësuar emërimin e tij si mbrojtës.⁴⁹

30. Duke pasur parasysh këto zhvillime dhe në përputhje me pjesën 13 të Direktivës, Trupi Gjykses fton Administratoren të ndërmarrë të gjithë hapat e

⁴⁸ Njoftimi për Marrëveshje, para. 1.

⁴⁹ Njoftimi për Marrëveshje, para. 1.

nevojshëm për të emëruar z. Mishetiq si kryembrojtës të z. Thaçi sa më shpejt që të jetë e realizueshme.

31. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa për Caktim është e tejkaluar dhe e hedh poshtë.

D. KËRKESA PËR PAGESË

32. Duke iu kthyer Kërkesës për Pagesë, Trupi Gjykses rikujton se sipas pjesës 16(4) të Direktivës, në interes të drejtësisë, Administratori mund të udhëzojë që mbrojtësi i emëruar ose i caktuar përfaqësimi i të cilit do të përfundohet, të vazhdojë të veprojë ose të ndihmojë mbrojtësin zëvendësues për një periudhë jo më shumë se dyzet e pesë (45) ditë nga data e caktimit ose emërimit të mbrojtësit zëvendësues. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të mbrojtësit që po largohet, përballohen nga DHS-ja.

33. Trupi Gjykses thekson se Administratorja *mund* të zgjedhë të udhëzojë z. Kihou të vazhdojë të veprojë ose ndihmojë si mbrojtës zëvendësues. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se mbrojtësi zëvendësues ende nuk është caktuar ose emëruar në këtë fazë dhe Administratorja nuk ka lëshuar udhëzime të tilla për z. Kihou. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se kërkesa për pagesë në këtë fazë është e parakohshme.

34. Për këto arsye, Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesën për pagesë.

V. KLASIFIKIMI

35. Trupi Gjykses thekson se Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit, (F02068), Parashtrimet Shtesë (F02079), Informacioni Shtesë (F02088), Njoftimi i Administratores (F02093), Përgjigjja e ZPS-së (F02094), dhe Njoftimi për Marrëveshje (F02116) u dorëzuan konfidencialisht sepse kanë të bëjnë me aspekte në lidhje me përfaqësimin juridik të z. Thaçi. Trupi Gjykses udhëzon përkatësisht Administratoren, ZPS-në dhe Mbrojtësin e Specializuar të dorëzojnë versionet e

redaktuara publike të parashtrimeve ose të kërkojnë riklasifikimin si publike sipas rregullës 82, një javë pas emërimit zyrtar të kryembrojtësit të ri të z. Thaçi.

VI. VENDIM

36. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues:

- (a) **MIRATON** Kërkesën për Përfundimin e Përfaqësimit dhe Kërkesën për Tërheqje në lidhje me tërheqjen e z. Kihou dhe z. Ridër, që për z. Kihou hyn në fuqi ditën e caktimit të kryembrojtësit të ri nga Administratorja për të përfaqësuar z. Thaçi;
- (b) **FTON** Administratoren të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të caktuar kryembrojtësin e ri për z. Thaçi sa më shpejt që të jetë e realizueshme;
- (c) **HEDH POSHTË** Kërkesën për Caktim dhe Kërkesën për Pagesë;
- (d) **UDHËZON** Administratoren të vendos në lidhje me kërkesën për tërheqje të tre ndihmësve juridikë dhe pesë ndihmësve administrativë të ekipit; dhe
- (e) **UDHËZON** Administratoren, ZPS-në dhe Mbrojtësin e Specializuar, që brenda javës së caktimit zyrtar të kryembrojtësit të ri të z. Thaçi, të dorëzojnë versionet e redaktuara publike ose të kërkojnë riklasifikim si publik të parashtrimeve të tyre përkatëse, konkretisht: Kërkesa për Përfundimin e Përfaqësimit (F02068), Parashtrime Shtesë (F02079), Informacion Shtesë (F02088), Njoftimi i Administratores (F02093), Përgjigjja e ZPS-së (F02094) dhe Njoftimi për Marrëveshje (F02116).

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 14 shkurt 2024

Në Hagë, Holandë.